



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 25 shtator 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në ushtrim të funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi, shqyrtoi çështjet e rendit të ditës dhe mori vendimet e mëposhtme:

U miratua kërkesa e shoqërisë “EUROTECH INNOVATION” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga një central fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Darzezë, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 15.11.2026 dhe, brenda 60 ditëve nga fillimi i operimit, të depozitojë pranë ERE-s dokumentacionin e testimit të veprës.

U vendos fillimi i procedurës për licencimin e shoqërisë “EURON SOLAR-PV” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 100 MW, me vendndodhje në fshatrat Fushë dhe Povelçë, Bashkia Fier. Shoqëria duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

U vendos pezullimi i procedurës administrative për modifikimin e licencës së shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. për prodhimin e energjisë elektrike, për rritjen e kapacitetit të instaluar të centralit fotovoltaike nga 50 MW në 100 MW, të licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s, datë 30.12.2024. Pezullimi do të zgjasë deri në paraqitjen pranë ERE-s të qëndrimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) lidhur me dokumentacionin përkatës të shoqërisë. Me paraqitjen e qëndrimit të AKM-së, procedura administrative do të rifillojë dhe do të vijojë shqyrtimi i kërkesës së shoqërisë për modifikimin e licencës.

U miratua kërkesa e shoqërisë “GSA” sh.p.k. për krijimin e llogarisë në Regjistrin Elektronik të Garancive të Origjinës, në kategorinë “Furnizues-tregtar i energjisë elektrike”. Shoqëria, e licencuar në veprimtaritë e tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike, ka plotësuar kërkesat dhe ka paraqitur të dhënat identifikuese të nevojshme për krijimin e llogarisë, në përputhje me përcaktimet e rregullores në fuqi.

U vendos fillimi i procedurës për miratimin e Rregullores “Për kërkesat minimale në përmbajtjen e faturave të energjisë elektrike dhe informacionin e faturimit”, e cila përcakton kërkesat minimale për përmbajtjen e faturave dhe informacionin që furnizuesit duhet t’u ofrojnë klientëve fundorë, duke përfshirë të dhënat mbi konsumin, matjen, çmimin, detyrimet financiare dhe të drejtat e klientëve. Projekt-rregullorja do t’i nënshtrohet konsultimit publik përpara miratimit përfundimtar.

U vendos fillimi i procedurës për miratimin e “Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike”, të cilat përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe klientëve, si dhe rregullat për faturimin, pagesën, trajtimin e ankesave dhe mosmarrëveshjeve, komunikimin dhe informimin e klientëve, ndryshimin e furnizuesit dhe masat për mbrojtjen e klientëve në nevojë. Projektakti do t’i nënshtrohet konsultimit me palët e interesuara dhe shoqatat që përfaqësojnë interesat e konsumatorëve, përpara miratimit përfundimtar.

Gjithashtu, në këtë mbledhje u shqyrtua raportimi i operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit në sektorin e energjisë për vitin 2026, në kuadër të monitorimit të përmbushjes së detyrimeve në fushën e sigurisë kibernetike. Nga raportimet rezulton se, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, nuk janë raportuar incidente të sigurisë kibernetike. Operatorët kanë vijuar zbatimin e masave organizative dhe teknike për mbrojtjen e sistemeve dhe informacionit, ndërsa janë evidentuar rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të masave të sigurisë.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.